



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm KSHPK) në seancën e62-të, të mbajtur më 15.02.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura në lëndën me numër 09-5605/1 nga 11.12.2019, e formuar pas denoncimit kundër personit ///, kandidate e propozuar për ///. **NDËRPRITET.**

Pas kontrollit dhe analizimit të të dhënave, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk është konstatuar shkelje e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pretendimet në denoncim nuk janë vërtetuar, pas së cilës KSHPK nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është duke vepruar për lëndën 09-5605/1 të datës 12.11.2019, i formuar pas kallëzimit të një parashtruesi të njohur me pretendimin për konflikt interesi, pasi pranë I///. "///" në Shkup, në bazë të konkursit të shpallur për zgjedhjen e asistentit për mësimdhënie ///, Komisioni recensues mori vendim dhe i propozoi Këshillit Shkencor të Institutit që të zgjedhë kandidatja /// si asistente në fushën e mësipërme , e cila tashmë ishte e punësuar si asistente në ///.

Në denoncim, parashtruesi i cili është një nga kandidatët që nuk janë përzgjedhur në konkurs, vë në dukje një konflikt interesi të anëtarëve të komisionit shqyrtues, si më poshtë: Prof. dr. ///, i cili ishte në marrëdhënie të ngushta miqësore me babain e kandidates së propozuar, ///; Prof. Dr. ///, mentor i temës së doktoraturës së kandidatit të propozuar dhe profesor vizitor i studimeve universitare dhe pasuniversitare në Fakultetin ///, në kohën kur babai i kandidatit ishte dekan i fakultetit me të njëjtin emër dhe asoc. Prof. Dr. ///, e punësuar në kohën kur dekan i fakultetit ishte babai i kandidates së propozuar.

Në denoncim gjithashtu thuhet se nuk dihet pse pikërisht këta profesorë përbëjnë komisionin, kur fusha e tyre akademike nuk barazohet me të drejtën e BE-së dhe të drejtat e njeriut.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në denoncim, Komisioni Shtetëror arrin në përfundimin se pjesa që ka të bëjë me një konflikt të mundshëm interesi nuk konfirmohet, sepse përshkrimi i dhënë për llojin e marrëdhënies ndërmjet anëtarëve të komisionit shqyrtues dhe

kandidatit tē propozuar nuk pērfshin pērkufizimin e personave tē afērt tē pērmendur nē nenin 8, paragrafi 4 i /// *“Me termin “persona tē afērt” nēnkuptohen personat nē bashkēsi martesore ose jashtēmartesore me person zyrtar, tē afērm gjaku nē vijē tē drejtē dhe anēsore deri nē shkallēn e katērt, tē afērm nga martesja deri nē shkallēn e dytē, si dhe çdo person fizik ose juridik me tē cilin personi zyrtar ka interes financiar”.*

Lidhur me pretendimet tjera pēr pērbērjen e komisionit, Komisioni Shtetēror i ēstē drejtuar Inspektoratit Shtetēror tē Arsimit dhe prej aty si institucion kompetent ka kērkuar inspektim tē jashtēzakonshēm lidhur me procedurēn e pērzgjedhjes sē anētarēve tē Komisionit Shqyrtues, i cili ka shqyrtuar dokumentet e kandidatēt e paraqitur nē Konkursin pēr pērzgjedhjen e asistentit nē drejtimet mēsimore-shkencore tē Drejtat dhe Liritē e Njeriut dhe E Drejta e BE-sē nē ///. “///” nē Shkup.

Nē afatin e pērcaktuar me ligj, Inspektorati Shtetēror i Arsimit ka njoftuar Komisionin Shtetēror se Inspektorati ka pērpiluar procesverbal UP1nr. 09-2939 datē 25.12.2019, nē tē cilin ēstē konstatuar se nuk ka lēshime lidhur me procedurēn e pērzgjedhjes sē asistentit nē ///. “///” nē Shkup pēr fushat mēsimore-shkencore - Tē drejtat dhe liritē e njeriut dhe tē drejtēn e BE-sē. Njoftim pēr gjendjen e konstatuar pēr rastin konkret i ēstē dorēzuar Avokatit tē Popullit tē RMV-sē, i cili ēstē njohur me rastin nga parashtruesi i denoncimit.

Nga kjo rezulton se pretendimet nē denoncim nuk vērtetohen, pēr çka Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit vendosi si nē dispozitiv tē kētij vendimi.

KOMISIONI SHTETЌОРОР
ПЌР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Kryetare,
Biljana Ivanovska

Sipas pērfundimit tē KSHPK-sē,
Punoi: E.N, bashkēpunētōr
Kontrolloji: K.Z., Udhēheqēsē
Miratoi: Mr.VG, anētār i KSHPK-sē